



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR KOMUNËN E DRAGASHIT
PËR VITIN FINANCIARTË PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018**

Prishtinë, qershor 2019

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e finansiardhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikat e mira evropiane.

“Univerzum Audit” Sh.p.k. ka kryer auditimin e Pasqyrave Financiare Vjetore të Komunës së Dragashit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, në emër të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore Komunës së Dragashit, në konsultim me menaxherin e kontratës Mujë Gashi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga “Univerzum Audit” Sh.p.k. nga Astrit Musa, udhëheqës i ekipit si dhe Valbona Shabani dhe Florentinë Peci, anetare.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit.....	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	10
4 Qeverisja e mirë.....	22
5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	24
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	35
Shtojca II: Letër konfirmimi.....	38

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetore të Komunës së Dragashit për vitin 2018, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 19.11. 2018.

Auditimi është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Komunës së Dragashit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim në çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2018 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se: Tek projekti i rrugës “Asfaltimi i rrugës Krushevë – Zlipotok (projekt 3 vjeçar”, komuna ka paguar faturën për Situacionin nr. 1 në vlerë 70,000€. bazuar në raportin e pranimit të punimeve i datës 20/12/2018 i vërtetuar nga menaxheri i kontratës. Brenda këtij situacioni ishte i përfshirë edhe pozicionet me Nr. 11, 12, 13, 14 – ‘Punët e betonit’ në një vlerë prej 36,002€. Gjatë ekzaminimit fizik me prezencën edhe të zyrtarëve komunal, konstatuam se punimet për këto pozicione nuk ishin realizuar. Vlera totale e këtyre pozicioneve ishte 36,002€ apo 51% e situacionit.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2018

Kryetari i Komunës është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Komunës gjatë procesit të auditimit.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Komunes së Dragashit, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përmbledhje të detajuar të gjetjeve tona të auditimit dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm

Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV, përfshirëdeklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Dragashit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se:

- Tek projekti i rrugës "Asfaltimi i rrugës Krushevë – Zlipotok (projekt 3 vjeçar", komuna ka paguar faturën për Situacionin nr. 1 në vlerë 70,000€. bazuar në raportin e pranimi të punimeve i datës 20/12/2018 i vërtetuar nga menaxheri i kontratës. Brenda këtij situacioni ishte i përfshirë edhe pozicionet me Nr. 11, 12, 13, 14 – 'Punët e betonit' në një vlerë prej 36,002€. Gjatë ekzaminimit fizik me prezencën edhe të zyrtarëve komunal, konstatuam se

punimet për këto pozicione nuk ishin realizuar. Vlera totale e këtyre pozicioneve ishte 36,002€ apo 51% e situacionit.

Opinioni jonë nuk është i modifikuar për këto çështje.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV

Kryetari i Komunës së Dragashit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë/Komunës/Institucionit të Pavarur.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave të SNISA-ve, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve; dhe
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK).
- Draft plani dhe plani përfundimtar i prokurimit; dhe
- Raportet e rregullta tremujore për Kuvendin Komunal dhe diskutimi i raporteve të AB-së dhe ZKA-së nga KK.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë.

Lidhur me kërkesat tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Për çështjen e sipër përmendur jepet rekomandimi:

Rekomandimi C1 Kryetari duhet të sigurojë që është bërë një analizë për të përcaktuar shkaqet për gjetjet e auditorit. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i forcuar kontrollet në procesin e pagesave, në mënyrë që të evitohen pagesat për të cilat punët/furnizimet nuk janë kryer. Komuna duhet të emërojë një komision të veçantë për punët/furnizimet, e pa pranuar/përfunduar i cili do të monitoroj këtë proces deri në kompletimin e plotë të tyre, në të kundërtën mjetet financiare të kthehen në buxhetin komunal. Veprime specifike duhet të merren gjithashtu për të siguruar se regjistrat e pasurisë janë të plotë dhe të saktë.

Gjithashtu, kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV-ve për vitin 2019 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Komuna ka një sistem të mirë të kontrolleve mbi shpenzimet dhe të hyrat krahasuar me vitin paraprak. Megjithatë, si rezultat i mos zbatimit të rregulloreve dhe udhëzimeve, auditimi ynë ka nxjerrë në pah ekzistencën e disa dobësive në aspektin e pajtueshmërisë, që kanë të bëjnë me prokurimin, si dhe shpenzimet tjera. Kjo reflekton një mungesë të mbikëqyrjes së duhur nga komuna në fushat e përmendura. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi regjistrimin dhe menaxhimin e pasurive në përgjithësi janë të dobëta dhe nuk janë duke u zbatuar në mënyrë efektive. Fushat tjera ku nevojiten më shumë përmirësime, janë procesi i menaxhimit dhe raportimit të llogarive të arkëtueshme.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ¹	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Burimet e Fondeve:	8,069,990	8,665,321	7,591,432	6,731,818	6,299,426
Granti i Qeverisë -Buxheti	7,511,138	7,450,968	7,215,850	6,341,807	6,047,798
Humarrja	98,195	102,733	69,961	14,425	-
Të bartura nga viti paraprak ²	-	637,935	158,748	82,193	84,140
Të hyrat vetjake ³	460,657	460,657	146,873	223,093	121,434
Donacionet e jashtme		13,028	-	70,300	46,054

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

² Të hyrat vetjake të komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

³ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 595,331€. Kjo ishte rezultat i të hyrave vetjake të bartura nga viti 2017 në vlerë 637,935€, rritjes së donacioneve në vlerë 13,028€, zvoglimit të grantit qeverisë në vlerë prej 59,161€ dhe rritjes në vlerë 4,538€ nga fondi për huamarrje.

Në vitin 2018, komuna ka shpenzuar 88% të buxhetit final apo 7,591,432€, me një performancë më të lartë krahasuar me vitin 2017 (qe ishte 82%). Realizimi i buxhetit në tërësi ishte në nivel të knaqshëm dhe më poshtë jepen shpejgimet për pozitën aktuale.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	8,069,990	8,665,321	7,591,432	6,731,818	6,299,426
Pagat dhe Mëditjet	4,529,869	4,470,708	4,469,699	4,252,501	4,243,671
Mallrat dhe Shërbimet	841,806	923,570	814,867	569,989	571,476
Shërbimet komunale	130,000	130,000	105,151	108,277	115,126
Subvencionet dhe Transferet	24,663	44,191	44,020	34,445	23,545
Investimet Kapitale	2,543,652	3,096,852	2,157,695	1,766,606	1,345,608

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore përfshirë arsyet dhe ndikim që kanë pasur:

- Pavarësisht rritjes së buxhetit për investime kapitale gjatë vitit, prej 553,200€, realizimi për këtë kategori është shpenzuar vetëm 70% e buxhetit final. Programi për Investime Publike përfshin disa projekte në vazhdim nga viti i kaluar dhe projekte të reja për vitin aktual.
- Buxheti final për paga dhe meditje është 4,470,708€ dhe është zvogëluar në vlerë 59,161€ dhe ishte shpenzuar në nivel 99% e buxhetit final. Kjo është bërë për shkak të shkurtimeve që janë bërë nga Ministria e Financave.
- Buxheti final për mallra dhe shërbime është rritur për 81,764€ krahasuar me buxhetin fillestar dhe ishte shpenzuar në nivel prej 88%. Ka pasur një njëtrajtshmëri në realizimin e shpenzimeve për mallëra dhe shërbime gjatë vitit.
- Buxheti final për shërbimet komunale nuk kishte ndryshime krahasuar me buxhetin fillestar, dhe ishte shpenzuar në nivel 81%.
- Komuna ka pas një buxhet fillestar për Subvencione dhe transfere në vlerë prej 24,663€ dhe kjo vlerë është rritur në 44,191€. Vlëra e shpenzuar për subvencione është mbi 99%. Këto subvencione janë përdor për nevoja shëndetësore të njerëzve në nevojë dhe aktivitete sportive të klubeve të komunës.

Çështja C2⁴ - Përmirësim në realizimin e investimeve kapitale

Gjetja Ekzekutimi i ulët lidhur me investimet kapital është sfida kryesore me të cilën përballet komuna. Edhe pse ka përmisim krahasuar me vitin e kaluar (në vitin 2017 ishte 59%), vetëm 70% e buxhetit të kësaj kategorie është shpenzuar. Kjo kishte ndodhur, nga që menaxhmenti nuk kishte bërë një planifikim real të shpenzimeve si dhe nuk kishte bërë analiza në baza të rregullta, mbi ecuritë buxhetore.

Rreziku Edhe pse ka përmirësim në realizimin e investimeve kapitale, shfrytëzimi jo efektiv i fondeve në dispozicion, do të rezultojë në mos arritjen e objektivave të organizatës, me pak projekte për qytetaret dhe në financimin e detyrimeve të vitit aktual nga buxhetet e vitit të ardhshëm.

Rekomandimi C2 Kryetari duhet të sigurojë që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Aty ku supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final.

3.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga komuna në 2018 ishin në vlerë 349,402€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, taksa për regjistrimin e automjeteve, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative etj. Komuna ende nuk ka të vendosur kontrole të brendshme efektive që kanë të bëjnë me mbledhjen/inkasimin e të hyrave. Në totalin e të hyrave vetjake të realizuara në tabelën në vijim nuk janë prezantuar të hyrat nga gjobate trafikut (45,422€), gjobat nga gjykata (3,580€), si dhe të hyrat nga ekonomia e pyjeve (10,515€).

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Pranimet	2017 Pranimet	2016 Pranimet
Të hyrat vetjake	460,657.00	408,918.83	349,402	363,709	418,123

Ka ende një rritje në nivelin e llogarive të arkëtueshme të Komunës dhe nuk ka pas ndonjë aktivitet të shtuar në mbledhjen e tyre.

⁴Çështja A dhe Rekomandimi A- nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja

Çështja B dhe Rekomandimi B- nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura

Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Buxheti final për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte 4,470,708€ ndërsa shpenzimet ishin prej 4,469,699€ apo mbi 99%.

Çështja C3- Mungesë e dëshmime për punët jashtë orarit dhe përvojës së punës

Gjetja Bazuar në Ligjin e Punës pagesa për punë jashtë orarit llogaritet për çdo orë pune, duke i shtuar edhe vlerën shtesë të llogaritur mbi pagën bazë (20%, 30% dhe 50%). Nga DKA nuk kemi pranuar listë të orëve shtesë dhe as dëshmi të përvojës së punës. Edhe pse efekti financiar nuk konsiderohet se është i lartë, vet fakti i ekzistimit të mangësive të tilla është tregues i mungesës së efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Rreziku Mungesa e evidencave të punës jashtë orarit nuk justifikon pagesat e bëra, dhe kalkulimi mund të rezultojë edhe me gabime në saktësinë e pagesave. Mangësitë e tilla rezultojnë me pagesa të parregullta dhe menaxhim jo adekuat të shpenzimit të pagave. Deri sa nuk kemi një pasqyrë të dëshmime të besueshëm dhe të mjaftueshme të përvojës së punës, të kontrolluar dhe autorizuar nga stafi kompetent, ka rrezik se të behën mbi pagesa apo nën pagesa në emër të përvojës së punës.

Rekomandimi C3 Kryetari duhet të sigurojë që kompensimi i punëtorëve për punë jashtë orarit/kujdestarive të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi, të mbaj evidenca të rregullta, në mënyrë që pagesa e tyre të jetë e rregullta dhe e dokumentuar. Si dhe duhet të siguroj që zyrtarët e personelit të kompletojnë dëshmitë për përvojën e punës së të punësuarave duke respektuar Vendimin e Qeverisë nr.06/29 të dt.15/05/2015 që përcakton rregullat dhe procedurat për dëshmimin e përvojës së punës.

Çështja C4 - Dosje jo të plota të punëtorëve si dhe mungesë e dosjeve elektronike

- Gjetja** Rregullorja 03-2011 për dosjet e nënpunësve civil, neni 1 parasheh të gjitha dokumentet që duhet ti përmbaj një dosje e punëtorëve. Gjatë procesit të auditimit kemi vërejtur se dosjet e punëtorëve nuk janë të kompletuara ashtu sic kërkohet me nenin 1. Për më tepër neni 1 dhe neni 9 i rregullores parasheh edhe dosjet elektronike. Gjatë auditimit ne kemi qenë në gjendje të sigurohemi për egzistencën e dosjeve elektronike.
- Rreziku** Mospërmbushja e obligimeve ligjore përsa i përket dosjeve të personelit të nënpunësve civil mund të shkaktoj konfuzion dhe trajtim jo te barabart të stafit.
- Rekomandimi C4** Kryetari duhet të siguroj që janë marrë masa se dosjet elektronike janë të kompletuara, ashtu që, në përpikëri ti përmbahet rregullores për dosjet e punëtorëve.

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2018 ishte 1,053,570€ (mallra 923,570.23€ dhe shpenzime komunale 130,000€). Prej tyre ishin shpenzuar 920,018€ (mallra dhe shërbime 814,867€ dhe shpenzime komunale 105,151€) ose shprehur në përqindje 87% e buxhetit.

Çështja C5 - Parregullsi në angazhimin e stafit për shërbime të veçanta

- Gjetja** Komuna gjatë vitit 2018 kishte angazhuar disa punonjës me kontrata për shërbime të veçanta. Pagesa për këto shërbime ishte bërë nga kategoria mallra dhe shërbime. Katër nga kontratat ishin lidhur për pozita të zakonshme e jo për ekspertë të fushave përkatëse. Njërit prej të angazhuarve në muajin nëntor nuk iu kishte ndalur tatimi në burim dhe kontribute pensionale, siç përcaktohet me ligjin Nr. 05-L-028. Po ashtu, janë deklaruar tatimet për pagë një muaj para se të kryhet pagesa e pagës si dhe dy punëtor janë paguar përnjëherë për gjashtë muaj, ose tre muaj.
- Rreziku** Angazhimi i stafit me marrëveshje për shërbime të veçanta për mbulimin e pozita të zakonshme ndikon në rritjen e shpenzimeve të shërbimeve kontraktuese dhe mund të rezultojë me shërbimet jo reale krahas nevojave të komunës. Mos ndalesa e tatimit në burim për personat e angazhuar përmes marrëveshjeve për shërbime të veçanta, rrit rrezikun që komuna të jetë objekt i ndëshkimeve nga autoritetet tatimore.
- Rekomandimi C5** Kryetari duhet të siguroj që kontratat e tilla të përdorën vetëm për shërbime të veçanta dhe jo për pozita të zakonshme. Ndërsa mbajtja e tatimeve në burim për personat e angazhuar me kontrata për shërbime të veçanta, duhet të bëhet në harmoni me legjislacionin e aplikueshëm në fuqi.

Çështja A1 - Blerjet deri ne 100€

Gjetja Gjatë procesit të auditimit kemi vërejtur se te kategoria mallëra dhe shërbime ka ndodh një numër i madhë i blerjeve nën 100€. Nga nje analizë e shkurtër del se gjithesej janë bërë 894 transaksione nga 90€ deri 99.99€ ne vlerën totale prej 87,179€. në këto transaksione nuk janë përfshirë shpenzimet për udhëtime zyrtare, shpenzimet postare, shpenzimet e komunalive etj. Ne nuk përjashtojmë mundësin që ndonjera prej pagesave të jetë bërë me kontratë, por shumica e këtyre blerjeve janë pa procedurë të prokurimit. Prej tyre, furnizim me mobilje kan qenë 1,943€ apo 20 raste. Fatura me e lartë ka qenë 99.50€ dhe më e ulëta 98€. Paisje tjera janë 151 transaksione në vlerë prej 13,742€, furnizim për zyre 158 transaksione në vlerë prej 14,072€, shërbime teknike 96 transaksione në vlerë prej 9,152€ dhe mirëmbajtja 37 transaksione në vlerë prej 3,161€.

Rreziku Edhe pse nuk është jashtë suazave ligjore që të bëhen blerjet nën 100€, numri i madh i këtyre transaksioneve tregon për një planifikim të dobët të nevojave të komunës dhe njësisive të saj. Për më tepër mund të vërehet sa ka një kontroll të dobët përsa i përket shpenzimeve dhe nevojave për blerjet e tilla. Zakonisht këto janë blerje ad hoc dhe të pa planifikuara si duhet.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të siguroj se jan bërë planifikimet e duhura të komunës dhe drejtorateve/njësive përkatëse që këto shërbime të kontratohen në mënyr që të minimizohet numri dhe vlera e blerjeve të tilla Planifikimi më i mirë mundëson eliminimin e blerjeve ad hoc dhe siguron në shfrytëzim më efikas të buxhetit komunal për nevojat reale për mallëra dhe shërbime të tilla. fuqi.

3.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 44,191€. Prej tyre në 2018 ishin shpenzuar 44,020€. Ato kanë të bëjnë me subvencionimin për entitete publike dhe jopublike, klube të sportit, organizatave jo qeveritare të ndryshme, shoqëri kulturo artistike etj. Krahasuar me vitin e kaluar ka një rritje të shpenzimeve për 9,575€, kjo është reflektuar nga rritja e buxhetit në krahasim me vitin e kaluar.

Rekomandime

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 3,096,852€. Prej tyre në 2018 ishin shpenzuar 2,157,695€. Ato kanë të bëjnë me ndërtimin e rrugëve, kanalizimeve, objekteve shkollore, etj.

Çështja B1 - Dobësi në menaxhimin e kontratave dhe pagesave për investime kapitale

Gjetja Disa nga projektet nuk kanë mundur të finalizohen për shkak të mos eliminimit të pengesave tjera paraprakisht, si në vijim:

- Tek projekti i rrugës “**Asfaltimi i rrugës Krushevë - Zlipotok (projekt 3 vjeçar)**”, komuna ka paguar faturën për Situacionin nr. 1 në vlerë 70,000€. bazuar në raportin e pranimit të punimeve i datës 20/12/2018 i vërtetuar nga menaxheri i kontratës. Brenda këtij situacioni ishte i përfshirë edhe pozicionet me Nr: 11 - beton i thjesht nën themele në vlerë prej 1,008€, 12 - beton për themelet në vlerë prej 11,228€, 13 - beton për muret në vlerë 9,856€, 14 - armimi i mureve mbajtëse në vlerë 13,910€.

Gjatë ekzaminimit fizik me prezencën edhe të zyrtarëve komunal, konstatuam se punimet për këto pozicione nuk ishin realizuar. Vlera totale e këtyre pozicioneve ishte 36,002€ apo 51% e situacionit;

- Tek projekti “**Ndërtimi i Stadionit të Qytetit në Dragash**”, komuna ka paguar faturën për Paramasa dhe Paralogaria për projektin në vlerë 45,125€ si dhe punimet e paparashikuara në vlerë prej 2,750€. Vlera totale e këtij projekti është 47,875€. Bazuar në raportin e pranimit të punimeve i datës 24/12/2018 i vërtetuar nga menaxheri i kontratës dhe nga komisioni për pranim teknik të projektit i cili është caktuar nga kryetari i komunës më datë 18.12.2018, brenda kësaj paramase dhe paralogaritje ishin të përfshira edhe pozicionet prej 22 deri më 28, ‘Material dhe punë që ndërlidhen me vendosjen e kubëzave’ në vlerë prej 5,217.50€. Gjatë ekzaminimit fizik me prezencën edhe të zyrtarit komunal, konstatuam se punimet për këto pozicione nuk ishin realizuar. Edhe pse materialet (kubëzat, zhavori etj) që ndërlidhen me këto punime ishin në vendpunishte.
- Tek projekti “**Ndërtimi i Shkollës Fillore në Loposhnik**”, komuna ka realizuar projektin në vlerë totale prej 305,000€. Prej tyre 16,419€ kanë qenë aneks kontratë dhe kontrata bazë ka qenë 288,581€. Bazuar në raportin e pranimit të punimeve i datës 19/12/2018 i vërtetuar nga menaxheri i kontratës, brenda kësaj paramase dhe paralogaritje ishin të përfshira edhe pozicioni i sistemit të kalldajës në vlerë prej 5,700€. Gjatë ekzaminimit fizik me prezencën edhe të zyrtarit komunal, konstatuam se kalldaja nuk ishte e vendosur në shkollë për shkak të mungesës së Kaldatores që duhet të ishte një aneks i veçant i shkollës për qëllim të vendosjes së kalldajës. Kalldaja ende qëndron në ambientet e kontraktorit në një lokacion tjetër dhe në bashkë me zyrtarin

komunal e kemi bërë verifikimin fizik të saj. Planifikimi i dobët në realizimin e projektit mund të shkaktoj vështësi në shfytëzueshmërin e projektit.

- Mungesa e projektit ekzekutiv- Në disa raste komuna nuk kishte bërë hartimin e projektit ekzekutiv. Sipas udhëzimit administrativ Nr. 1/2014 Për përgatitjen specifikeve teknike për kontratat për punë kërkohet që Specifikat Teknike duhet të përfshijnë, si pjesë substanciale të vetëm, një projekt ekzekutiv të përpiluar.

Rreziku

Mangësitë e identifikuar kanë rezultuar me mos respektim të procedurave të prokurimit sipas Udhëzimit Operativ të LPP-së. Komuna nuk ka arrit të përmbush objektivat e planifikuara të infrastrukturës në shërbim të taksapaguesve apo kthimin e kundërvlerës për taksën e paguar të qytetarit të Dragashit. Me tutje zhvillimi i procedurave të prokurimit pa një projekt të hartuar paraprakisht mund të ndikoj që punimet e zbatuara në këto projekte të devijojnë nga kërkesat standarde të ndërtimit dhe të mos arrijnë cilësinë e duhur.

Rekomandimi B1

Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha zotimet e kontraktuara janë duke u realizuar në përpikëri dhe konform kushteve të parashtruara, duke eliminuar pengesën para hyrjes në marrëveshje kontraktuese. Nëse përjashtimisht paraqitet nevoja për ndërprerje të kontratës duhet të ndiqen procedurat e nevojshme sikurse është paraparë me Ligjet dhe Udhëzimet në fuqi. Gjithashtu duhet të siguroj se hartimi i projekteve ekzekutive i paraprinë inicimit të aktiviteteve të prokurimit të kontratat për punë sipas kërkesave të UA nr. 1/2014.

Çështja A2 - Dobësi në planifikim të investimeve kapitale

Gjetja

Gjatë auditimit kemi vërejtur që ka pas planifikim jo të mirë të shpenzimeve kapitale: Ndër to, shkolla në fshatin Kosav, ku fillimisht është paraparë buxhet 43,359€. Kompania fituese nuk i ka plotësuar të gjitha kriteret për tender, më saktësisht kriterin administrativ apo ISO standardin 9001. Tenderi është rishpallur dhe buxheti thuhet se është dyfishuar në vlerë 83,359€, përkundër faktit që paramasa ka mbetur e njëjtë. Fillimisht ky projekt është paraparë të përfundojë për një vit, ndërsa kur është ritenderuar kohëzgjatja e projektit është zgjatur në dy vite.

Rreziku

Praktika e tillë shton rrezikun e mos arritjes së vlerës për para dhe dëmtojnë transparencën, eliminojnë konkurrencën dhe vejnë në pikëpyetje cilësinë e shërbimeve dhe produkteve të pranuar.

Rekomandimi A2

Kryetari duhet të siguroj që bëhet një planifikim i hollësishëm dhe njësitë kërkuese duhet të vlerësojnë në mënyrë të drejtë kërkesat për prokurim.

3.1.6 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale:

Çështja B2- Shmangie e procedurave të hapura të prokurimit

Gjetja Sipas raportit të kontratave të nënshkruara për vitin 2018 komuna kishte nënshkruar 94 kontrata përmes procedurës me vlerë minimale. Gjatë auditimit kemi vërejtur se ka ndarje të tenderëve, ku për furnizime dhe shërbime të natyrës së njëjtë janë zhvilluar një numër i procedurave si:

- "Furnizim me kompjuter" janë zhvilluar dy procedura në vlerë totale 1,604€;
- "Furnizim me laptop, janë zhvilluar dy procedura në vlerë totale 1,495€;
- "Furnizimi dhe montimi i kamerave të sigurisë", janë zhvilluar dy procedura në vlerë 1,518€;
- "Furnizim me material hixhienik", janë zhvilluar katër procedura në vlerë 3,321€; dhe
- "Furnizim me material didaktik" janë zhvilluar dy procedura në vlerë 1,988€.

Rreziku Praktika e tillë shton rrezikun e mos arritjes së vlerës për para dhe dëmtojnë transparencën, eliminojnë konkurrencën dhe vejnë në pikëpyetje cilësinë e shërbimeve dhe produkteve të pranuar.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të siguroj që bëhet një planifikim i hollësishëm dhe njësitë kërkuese duhet të vlerësojnë në mënyrë të drejtë kërkesat për prokurim.

3.2 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Menaxhimi i pasurisë është një pjesë e rëndësishme e menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik. Një menaxhim i mirë i pasurive kërkon që komuna të ketë një pamje të plotësisë të pasurive, procedura të kontrollit dhe menaxhimit të tyre dhe të azhurnojë vazhdimisht ndryshimet në regjistrat e saj.

Vlera e tërësishme e pasurisë mbi 1,000€ ishte 15,948,608€, ndërsa ato nën 1,000€ ishin prezantuar në vlerën prej 259,231€. Në anën tjetër vlera e pasurive nën 1,000€ të regjistruara në E-pasuria është 87,569€. Nga numrimi fizik, nuk është bërë azhurimi i pasurive nën 1,000€ në E-pasuria.

Çështja C6 - Mangësi në inventarizimin e pasurisë

Gjetja Komisioni për vlerësimin e Pasurisë Jo-Financiare është formuar. Janë regjistruar dhe vlerësuar pasuritë në posedim të Komunës. Ka mangësi tek regjistrimi përkatësisht tek vendosja e nr. serik, nr i barkodit dhe sasia. Ndryshimet në lokacion, tjetërsim apo ndryshimet e tjera nuk kanë qenë të harmonizuara dhe të barazuara në mes raporteve të komisionit për vlerësim dhe regjistrim të pasurisë fikse (jofinanciare). Edhe pse ka pasuri të cilat janë jashtë përdorimit apo pasuri që komisioni për vlerësim gjatë vlerësimit nuk ka mundur ti shohë, ato janë pjesë e këtij raporti të komisionit vlerësues. Të dhënat mbi pasurinë nuk mirëmbahen dhe nuk përmiresohen, sistemakisht varësisht nga ndryshimet që pësojnë.

Rreziku Mos realizimi i plotë i inventarizimit të pasurisë siç kërkohet me rregullore, mund të rezultojë që komuna të mos identifikoj gjendjen reale dhe faktike të pasurive të cilat mund të jenë të dëmtuara ose mungojnë plotësisht. Kjo mund të rezultojë në mbajtjen në pasqyrat financiare të pasurive të cilat nuk ekzistojnë apo kanë vlerë më të ulët se ajo me të cilën ata janë prezantuar në PFV.

Rekomandimi C6 Kryetari të siguroj që komisioni i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurisë jo financiare të bëjë regjistrimet dhe vlerësimin e të gjitha pasurive në posedim të komunës, dhe pas përfundimit të procesit të përgatit një raport përfundimtar mbi gjendjen e pasurive, të cilin duhet ta harmonizoj me regjistrat kontabël të komunës. Diferencat e shfaqura duhet të sqarohen dhe regjistrat duhet të azhurnohen sipas të dhënave të regjistrimeve të fundit.

Çështja C7 - Regjistri i pasurisë nën 1,000€

Gjetja Regjistri i pasurisë nën 1,000€ ka filluar të funksionojë, komuna ofron regjister sic është paraparë në nenin 6, të rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive financiare, mirëpo ky regjister nuk mirëmbahet, mungon evidencë e tyre dhe të dhënat për zhvlerësimin dhe vlerën e tyre neto. Ky regjistër nuk i përfshin të gjitha pasuritë të cilat sipas raportit nga Komisioni për vlerësimin e pasurive janë në posedim të komunës, përkatësisht në mes regjistrit të e-pasurisë në vlerë 87,568€ dhe raportit nga komisioni për vlerësimin e pasurisë në vlerë 259,230€ ka një diferencë në vlerë 171,662€. Të gjitha regjistrimet në regjistrin e e-pasurisë për vitin 2018 janë bërë në të njejtën datë.

Rreziku Evidenca jo e saktë e pasurisë financiare dhe jofinanciare mund të rezultojë në mbivlerësim apo nënvlerësim të bilancit të gjendjes të komunës. Për më tepër, kjo mund të rezultojë edhe në menaxhim të dobët të pasurive të komunës.

Rekomandimi C7 Kryetari duhet të sigurohet se regjistri i pasurisë nën 1,000€ mirëmbahet, kontrollohet dhe të gjitha asetet e komunës mund të evidentohen sipas kriterëve të përcaktuara në rregullore.

Çështja A3- Mospërputhje në vlerën e tokës në mes të raporteve

- Gjetja** Gjatë vitit 2018 komuna ka themeluar komisionin për regjistrimin e tokave që ka qenë rekomandim nga viti paraprak. Gjatë vitit 2018 në regjistrin e pasurive në SMIFK janë përfshirë parcelat e Tokës prej 11,154.08 hektarë në vlerë në 13,700,166€, qe i bie se nga 30,036 hektarë (në këtë nuk janë të përfshira lumenjtë, rrugët etj) që kanë qenë të paregjistruara në regjistrin e pasurisë tash kanë mbetur 18,881.92 hektarë të paregjistruara, që ende janë në kontest gjyqësor me ndërmarrjen shoqërore 'Sharrprodhimi'.
- Rreziku** Mospërfshirja e pasurisë së komunës në pasqyrat financiare mund të rezultojë në nëndeklarimin e pasurive në pasqyra dhe si rrjedhojë nuk tregon pasqyrën e saktë të pasurive që komuna ka në dispozicion.
- Rekomandimi A3** Kryetari duhet të sigurohet që të gjitha pasuritë e komunës të jenë të përfshira në pasqyrat financiare të komunës në mënyrë që pasqyrat financiare të tregojnë një gjendje të saktë të pasurive të saj.

3.3 Trajtimi i parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj

Paratë e imta janë fond i vogël i parave që mbahet në përkujdesjen dhe kontrollin e komunës, departamentit ose njësive më të vogla buxhetore varësisht nga ndarjet buxhetore, dhe që shfrytëzohet për të mbuluar shpenzimet me vlerë të vogël (deri 100€).

Çështja B3 - Vonesa në depozitimin e parasë së gatshme

- Gjetja** Rregullorja financiare për të hyrat 03/2010 përcakton që të hyrat e grumbulluar në formë të parasë së gatshme në arkë (në shumën 10€), deri në fund të ditës duhet të depozitohen në llogari përkatëse të autorizuar. Shuma prej 572.50€ që i përket të hyrave nga shëndetësia ishte deponuar me datën 03/08/2018, ndërsa të hyrat ishin grumbullim i parave në QKMF që nga muaji Maj 2018 deri në muajin korrik 2018. Deponim ishte bërë me vonës prej tri ditë deri në tre muaj.
- Rreziku** Depozitimi i vonuar i parasë së grumbulluar në arka rritë rrezikun e keqpërdorimit të parasë publike. Kjo shpie të raportimi jo i drejt i periudhës kohore të grumbullimit të të hyrave përkatëse, dhe përveç kësaj, një praktikë e tillë nuk është në pajtueshmëri me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- Rekomandimi B3** Kryetari duhet të sigurojë se depozitat e përditshme të parasë dhe kontrollet janë kryer ashtu siç kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

3.4 Të arkëtueshmet

Lista e debitorëve ndaj komunës, sipas të dhënave në PFV është 1,832,000€. Ato kanë të bëjnë me tatimin në pronë në vlerë 974,000€, taksa në firmë 597,000€, si dhe të arkëtueshmet nga shfrytëzimi i pronës komunale 262,000€. Në përgjithësi vlera e të arkëtueshmeve ka shënuar një rritje prej 4% në krahasim me vitin e kaluar.

Çështja A4- Rritja e llogarive të arkëtueshme

Gjetja Edhe pse ka një rritje konstante të llogarive të arkëtueshme, komuna nuk ka marrë veprimet e nevojshme për të krijuar mekanizma për të rritur inkasimin e të hyrave të faturuara. Si pasojë, të arkëtueshmet edhe me tutje janë shumë të larta, ose në nivel më të lartë në raport me vitin paraprak për 80,000€.

Rreziku Mungesa e masave konkrete për të inkasuar llogaritë e arkëtueshme vazhdon të rezultojë në nivele të larta të tyre dhe rrjedhimisht edhe me reduktimin e fondeve të mbledhura për buxhetin komunës. Gjithashtu, kjo redukton edhe fleksibilitetin e komunës ndaj shpenzimeve të planifikuara që financohen nga të hyrat vetjake.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet të sigurojë forcimin e mekanizmave për inkasimin e të hyrave të saj, përfshirë edhe të arkëtueshmet e mbetura nga vitet paraprake. Fillimisht duhen të shfrytëzohen të gjitha veprimet e nevojshme në kuadër të komunës, me pas të shfrytëzoj edhe masat tjera ligjore për të siguruar inkasimin e tyre.

3.5 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2018 ishte 4,000€. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2019. Komuna përballet edhe me detyrime kontingjente ku në PFV janë prezantuar në vlerë prej 197,000€, ndersa vitin e kaluar shuma totale e detyrimeve kontigjente ishte 248,000€.

Çështja C8 Vonesa në pagesën e faturave

- Gjetja** Gjatë analizimit të raportit të obligimeve të prezantuar në PFV kemi vërejtur se 12 fatura në vlerë 1,387€ kanë kaluar afatin prej 30 ditësh për pagesë. Këto obligime të papaguara ngarkojnë drejtpërsëdrejti buxhetin e vitit 2019.
- Rreziku** Si pasojë e vonesës së pagesave, mund të dobësohet aftësia e komunës për të menaxhuar dhe parashikuar nevojat për likuiditet. Për më tepër komuna rrezikon tu nënshtrohet gjobave dhe interesit për interes të pagesa
- Rekomandimi C8** Kryetari duhet të përcaktoj të gjitha masat e nevojshme për adresimin e çështjeve të identifikuar dhe pagesat të bëhen në kuadër të limiteve kohore të përcaktuara me rregullat financiare.

4 Qeverisja e mirë

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmer veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda Komunës veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Përgjigjet efektive ndaj zbatimit të rekomandimeve të auditimit të jashtëm, zhvillimi mbi proceset e menaxhimit të rrezikut, menaxhimi i projekteve kapitale dhe pasurisë komunale, si dhe zbatimi i rekomandimeve të auditimit të brendshëm janë disa nga fushat të cilat komuna duhet dhënë prioritet sa i përket një qeverisjeje më efektive.

Të gjitha organizatat buxhetore (për Komuna) janë të obliguara të përgatisin dhe të përcjellin planet strategjike në nivel të organizatës, si: planet urbanistike, hapësinore, plani operativ emergjent, plani strategjik kundër korrupsionit, strategjia e zhvillimit rajonal etj.

Komuna posedon planin strategjik të zhvillimit rajonal, planin operativ të veprimit emergjent dhe civil dhe nuk posedon këto: planet urbanistike, hapësinore, , plani strategjik kundër korrupsionit.

4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me një anëtarë të stafit - Drejtori i NjAB. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të entitetit të audituar dhe që ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i raporteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga një Komitet efektiv i Auditimit. NJAB kishte hartuar Planin vjetor të punës sipas të cilit ka planifikuar gjashtë auditime të cilat ishin realizuar në tërësi. Auditimet kanë mbuluar fushën e prokurimit, të hyrat, shpenzimet komunale sipas linjave buxhetore, personelin si dhe menaxhimin e pasurisë. Marrë parasysh buxhetin e komunës, sipas kërkesave UA. 23/2009 për themelimin dhe funksionimin e NjAB-së , përbërja e kapaciteteve të kësaj njësie me vetëm një auditor, nuk është e mjaftueshme. Gjatë vitit 2018 komuna e ka themeluar Komitetin e Auditimit dhe gjatë vitit 2018 ky komitet është mbledhur gjashtë herë.

Çështja C9 - Mos adresimi i rekomandimeve te NjAB

Gjetja Në gjashtë raportet e përfunduara, NjAB kishte dhënë 31 rekomandime se si menaxhmenti të përmirësojë funksionimin e kontrollit të brendshëm, nga të cilat 9 ishin të proces të zbatimit, ndërsa 22 kanë mbetur të pazbatuara.

Rreziku Dështimi për të adresuar rekomandimet e auditimit rrisin rrezikun që dobësitë e identifikuara nga auditimi të mbesin të pa përmirësuara dhe potencialisht mund të rezultojnë humbje financiare për komunën dhe vlerë të dobët për para. Në mungesë të kontributit të KA-së zvogëlohet efikasiteti i sistemit të Auditimit të brendshëm si tërësi.

Rekomandimi C9 Kryetari duhet të sigurojë se do të plotësohet me personel të mjaftueshëm NjAB, si dhe të rishikojë arsyet për veprimet e limituara të ndërmarra në lidhje me rekomandimet. Gjithashtu duhet të ndermirren veprime shtesë për funksionalizimin e KA-të në mënyrë që të sigurojë mbikëqyrjen, ngritjen dhe fuqizimin e rolit të auditimit të brendshëm.

4.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranimit i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalesje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një

proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuara janë të dobëta dhe jo efektive dhe nuk mundësojnë një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Të gjitha organizatat buxhetore pritet të zbatojnë kërkesat për vlerësimin e rrezikut. Udhëzimet e përcaktuara në procedurat e MFK-së kërkojnë që regjistri i rrezikut të jetë i kompletuar për të mbështetur menaxhimin efektiv operacional dhe strategjik.

Çështja C10 - Dobësi në kontrollet menaxheriale

Gjetja Komuna ka politika të shkruara dhe procedura për menaxhimin e rreziqeve, mirëpo gjatë procesit të auditimit kemi vërejtur se komuna nuk kishte hartuar planin kundër korrupsionit.

Rreziku Mos hartimi i politikës kundër korrupsionit mund ta dëmtojë komunën dhe pasuritë e saj.

Rekomandimi C10 Kryetari duhet të siguroj se është hartuar politika kundër korrupsionit dhe ajo duhet të zbatohet në përpikmëri në mënyrë që të minimizohen rreziqet nga korrupsioni.

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2018 të Komunës së Dragashit ka rezultuar në 19 rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2018, 5 rekomandime janë zbatuar; 11 ishin në proces dhe 3 nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve)

Çështja C11 - Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm

- Gjetja** Komuna, ka hartuar një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve, mirëpo kjo nuk është mbështetur me një proces konfirmues ku zbatimi i tyre monitorohet formalisht. Kjo pasqyron mungesën e fokusit nga menaxhmenti për të siguruar që rekomandimet zbatohen me kohë dhe pengesat për veprim pritet të identifikohen dhe adresohen. Si pasojë dobësitë e prezantuara në raportet e viteve paraprake ende janë evidente si: mos realizim i kënaqshëm i buxhetit në kategorinë e investimeve kapitale, mos regjistrim të plotë të pasurisë, dhe jo efikasiteti i vazhdueshëm organizativ për koordinimin e realizimit të inkasimit të të hyrave.
- Rreziku** Mos zbatimi i plotë i rekomandimeve rritë rrezikun e pranisë së vazhdueshme të mangësive të njëjta dhe mund të rezultojë në mos efikasitet të vazhdueshëm të kontrolleve, vështirësi në menaxhimin e sfidave në përmbushjen e objektivave apo edhe në humbje financiare.
- Rekomandimi C11** Kryetari duhet të sigurojë që zbatimi i planit të veprimit, monitorohet në vazhdimësi dhe raportohet në baza të rregullta mujore ose tre mujore në lidhje me progresin e arritur në këtë drejtim. Rekomandimet të cilat nuk zbatohen sipas afateve, të rishikohen në një afat të shkurtër nga kryetari, si dhe të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2018

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2017	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore	<p>Kryetari duhet të sigurojë që është bërë një analizë për të përcaktuar shkaqet për Kualifikim dhe Theksim të çështjes. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i forcuar kontrollet në procesin e pagesave, në mënyrë që të evitohen pagesat për të cilat punët/furnizimet nuk janë kryer. Komuna duhet të emërojë një komision të veçantë për punët/furnizimet, e pa pranuar/përfunduar i cili do të monitoroj ketë proces deri në kompletimin e plotë të tyre, në të kundërtën mjetet financiare të kthehen në buxhetin komunal. Veprime specifike duhet të merren gjithashtu për të eliminuar mundësinë për prezantimin e gabimeve lidhur me të hyrat dhe shpenzimet, si dhe për të siguruar se regjistrat e pasurisë janë të plotë dhe të saktë. Gjithashtu, kryetari duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV-ve për vitin 2018 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.</p>		Rekomandim pjesërisht i zbatuar

2	Nivel i ulët i realizimit të investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që përforma buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Aty ku supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final.	Ka permiresime ne realizimin e investimeve kapitale ne krahasim me vitin e kaluar. Kete vit realizimi eshte 70% e buxhetit.	Rekomandim pjesërisht i zbatuar
3	Regjistrimi dhe prezantim jo i drejt i të hyrave	Kryetari duhet të siguroj se ndërmerren aktivitete të domosdoshme që të hyrat regjistrohen dhe prezantohen në përputhje të plotë me planin kontabël.		Rekomandim i zbatuar
4	Menaxhim jo adekuat i të hyrave nga tatimi në pronë	Kryetari duhet të sigurojë se verifikimi i pronave të bëhet në baza të rregullta vjetore sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, që reflekton shënime të përditësuara të regjistrit dhe ngarkesave të saktatimore. Veprime shtesë duhet të ndërmerren që të siguroj se zbritjet për 10,000€ aplikohet vetëm për vendbanimet kryesore.	Po. Është bërë verifikimi i 1/5 së pronave sipas rregullores në fuqi.	Rekomandim i zbatuar
5	Parregullsi në dhënien me qira të pronave komunale	Kryetari duhet t'i analizoj rastet e përmendura më lartë dhe të siguroj së dhënia e këtyre pronave në shfrytëzim të jetë në harmoni të plotë me kërkesat ligjore. Gjithashtu, në të ardhmen, të siguroj se dhënia në shfrytëzim e pronës publike të organizohet sipas procedurës së ankandit publik dhe të nënshkruhen kontratat sipas legjislacionit.		Rekomandim i zbatuar

6	Mungesë e dëshmive për punët jashtë orarit dhe përvojës së punës	Kryetari duhet të sigurojë që kompensimi i punëtorëve për punë jashtë orarit/kujdestarive të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi, të mbaj evidenca të rregullta, në mënyrë që pagesa e tyre të jetë e rregullta dhe e dokumentuar. Si dhe duhet të siguroj që zyrtarët e personelit të kompletojnë dëshmitë për përvojën e punës së të punësuarave duke respektuar Vendimin e Qeverisë nr.06/29 të dt.15/05/2015 që përcakton rregullat dhe procedurat për dëshmimin e përvojës së punës.	Departamenti i shëndetesisë ka rregulluar evidentimin e punëve jashtë orarit, ndërsa departamenti i arsimit ende jo.	Rekomandim pjesërisht i zbatuar
7	Mungesë e dosjeve të personelit	Kryetari të siguroj rishikimin e marrëveshjes së mirëkuptimit dhe të gjej mundësi që këta zyrtarë të transferohen në institucionet ku ata punojnë, ose të kompletohen dosjet e tyre në komunë për të krijuar bazë ligjore për ekzekutimin e pagave të tyre.	Ka përmirsim por ende dosjet nuk janë komplete dhe nuk kanë dosje elektronike.	Rekomandim pjesërisht i zbatuar
8	Parregullsi në angazhimin e stafit për shërbime të veçanta	Kryetari duhet të siguroj që kontratat e tilla të përdorën vetëm për shërbime të veçanta dhe jo për pozita të zakonshme. Ndërsa mbajtja e tatimeve në burim për personat e angazhuar me kontrata për shërbime të veçanta, duhet të bëhet në harmoni me legjislacionin e aplikueshëm në fuqi.	Ka përmirsim por edhe kontrata me zëra të zakonshëm.	Rekomandim pjesërisht i zbatuar
9	Regjistrim dhe prezantim i gabuar i subvencioneve	Kryetari duhet të siguroj që zyrtari i shpenzimeve e bën klasifikimin e duhur të shpenzimeve sipas planit kontabël dhe pagesat për subvencione të regjistron nëpër kodet përkatëse.		Rekomandim i zbatuar

10	Dobësi në menaxhimin e kontratave dhe pagesave për investime kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha zotimet e kontraktuara janë duke u realizuar në përpikëri dhe konform kushteve të parashtruara, duke eliminuar pengesën para hyrjes në marrëveshje kontraktuese. Nëse përjashtimisht paraqitet nevoja për ndërprerje të kontratës duhet të ndiqen procedurat e nevojshme sikurse është paraparë me Ligjet dhe Udhëzimet në fuqi. Gjithashtu duhet të siguroj se hartimi i projekteve ekzekutive i paraprinë inicimit të aktiviteteve të prokurimit të kontratat për punë sipas kërkesave të UA nr. 1/2014.		Rekomandim i pa zbatuar
11	Shmangie e procedurave të hapura të prokurimit	Kryetari duhet të siguroj që bëhet një planifikim i hollësishëm dhe njësitë kërkuese duhet të vlerësojnë në mënyrë të drejtë kërkesat për prokurim.		Rekomandim i pa zbatuar
12	Mangësi në pranimin, regjistrimin dhe prezantimin e shpenzimeve	Kryetari duhet të sigurojë se zyrtari i pranimit bën përshkrimin e mallit/punës të pranuar me qëllim të konfirmimit se furnizimet/punët janë pranuar konform kontratës, nga ana e zyrtareve kompetent. Gjithashtu duhet të vendos kontrolle funksionale për tu siguruar se pagesat bëhen sipas kodeve adekuate dhe të krijohet një strategji e përgjithshme për të përfshirë buxhetimin e tyre me kohë.		Rekomandim i zbatuar
13	Mangësi në inventarizimin e pasurisë	Kryetari të siguroj që komisioni i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurisë jo financiare të bëj regjistrimet dhe vlerësimin e të gjitha pasurive në posedim të komunës, dhe pas përfundimit të procesit të përgatit një raport përfundimtar mbi gjendjen e pasurive, të cilin duhet ta harmonizoj me regjistrat kontabël të komunës. Diferencat e shfaqura duhet të sqarohen dhe regjistrat duhet të azhurnohen sipas të dhënave të regjistrimeve të fundit.	Inventarizimi është kryer por nuk është bërë azhurimi i SMIFK dhe E-pasuria	Rekomandim pjesërisht i zbatuar

14	Mungesë e procedurës së brendshme dhe regjistrimit të pasurisë nën 1,000€	Kryetari duhet të siguroj hartimin e rregullave dhe procedurave të brendshme për evidencën, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare sipas kërkesës së rregullores 02/2013, si dhe të sigurojë se procesi gjithëpërfshirës i regjistrimit të pasurive do të vazhdoj, dhe brenda një afati optimal do të nxirret një regjistër përfundimtar mbi pasuritë e komunës. Po ashtu të gjitha hyrjet/daljet e pasurive të luajtshme me vlera nën 1,000€ të bëhen përmes sistemit e-pasuria në të gjitha dikasteret komunale.	Është bërë hartimi I rregullores së brendshme për asete, mirëpo nuk përcillen hyrjet/daljet e pasurive.	Rekomandim pjesërisht i zbatuar
15	Vonesa në depozitim të parasë së gatshme	Kryetari duhet të sigurojë se depozitat e përditshme të parasë dhe kontrollat janë kryer ashtu siç kërkohet nga legjislacioni në fuqi.		Rekomandim i pa zbatuar
16	Vonesa në pagesën e faturave	Kryetari duhet të përcaktojë të gjitha masat e nevojshme për adresimin e çështjeve të identifikuar, dhe pagesat të bëhen në kuadër të limiteve kohore të përcaktuara me rregullat financiare.	Nga 17 fatura të papaguara pas afatit 30 ditësh në vitin 2017, ka rënë në 12 fatura të papaguara brenda afatit 30 ditor.	Rekomandim pjesërisht i zbatuar
17	Niveli i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm	Kryetari duhet të sigurojë që zbatimi i planit të veprimit, monitorohet në vazhdimësi dhe raportohet në baza të rregullta mujore ose tre mujore në lidhje me progresin e arritur në këtë drejtim. Rekomandimet të cilat nuk zbatohen sipas afateve, të rishikohen në një afat të shkurtër nga kryetari, si dhe të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.		Rekomandim pjesërisht i zbatuar

18	Mangësi në funksionimin e NjAB	Kryetari duhet të sigurojë se do të plotësohet me personel të mjaftueshëm NjAB, si dhe të rishikojë arsyet për veprimet e limituara të ndërmarra në lidhje me rekomandimet. Gjithashtu duhet të ndermirren veprime shtesë për funksionalizimin e KA-të në mënyrë që të sigurojë mbikëqyrjen, ngritjen dhe fuqizimin e rolit të auditimit të brendshëm.	KA është formuar dhe ka mbajtur 4 takime në 2018. Ka ende dobësi në zbatimin e rekomandimeve të auditorit të brendshëm.	Rekomandim pjesërisht i zbatuar
19	Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut	Kryetari duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili mund të nxirren të gjitha informatat relevante që ndikojnë në vendimmarrjen cilësore dhe me kohë të menaxhmentit. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, dhe plani i prokurimit duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e ekspozuara.	Eshtë hartuar lista e rreziqeve,	Rekomandim pjesërisht i zbatuar
Nr	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2018		
1	PVF	Kryetari duhet të sigurojë që është bërë një analizë për të përcaktuar shkaqet për gjetjet e auditorit. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i forcuar kontrollet në procesin e pagesave, në mënyrë që të evitohen pagesat për të cilat punët/furnizimet nuk janë kryer. Komuna duhet të emërojë një komision të veçantë për punët/furnizimet, e pa pranuar/përfunduar i cili do të monitoroj ketë proces deri në kompletimin e plotë të tyre, në të kundërtën mjetet financiare të kthehen në buxhetin komunal. Veprime specifike duhet të merren gjithashtu për të eliminuar mundësinë për prezantimin e gabimeve lidhur me shpenzimet, si dhe për të siguruar se regjistrat e pasurisë janë të plotë dhe të saktë.		

2	Përmirësim në realizimin e investimeve kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Aty ku supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final.
3	Mungesë e dëshmimeve për punët jashtë orarit dhe përvojës së punës	Kryetari duhet të sigurojë që kompensimi i punëtorëve për punë jashtë orarit/kujdestarive të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi, të mbaj evidenca të rregullta, në mënyrë që pagesa e tyre të jetë e rregullta dhe e dokumentuar. Si dhe duhet të siguroj që zyrtarët e personelit të kompletojnë dëshmitë për përvojën e punës së të punësuarave duke respektuar Vendimin e Qeverisë nr.06/29 të dt.15/05/2015 që përcakton rregullat dhe procedurat për dëshmimin e përvojës së punës.
4	Dosje jo të plota të punëtorëve si dhe mungesë e dosjeve elektronike	Kryetari duhet të siguroj që janë marrë masa se dosjet elektronike janë të kompletuara, ashtu që, në përpikëri ti përmbahet rregullores për dosjet e punëtorëve.
5	Parregullsi në angazhimin e stafit për shërbime të veçanta	Kryetari duhet të siguroj që kontratat e tilla të përdorën vetëm për shërbime të veçanta dhe jo për pozita të zakonshme. Ndërsa mbajtja e tatimeve në burim për personat e angazhuar me kontrata për shërbime të veçanta, duhet të bëhet në harmoni me legjislacionin e aplikueshëm në fuqi.
6	Blerjet deri në 100€	Kryetari duhet të siguroj se janë bërë planifikimet e duhura të komunës dhe drejtorateve/njësive përkatëse që këto shërbime të kontratohen në mënyrë që të minimizohet numri dhe vlera e blerjeve të tilla Planifikimi më i mirë mundëson eliminimin e blerjeve ad hoc dhe siguron në shfrytëzim më efikas të buxhetit komunal për nevojat reale për mallëra dhe shërbime të tilla. fuqi.
7	Dobësi në menaxhimin e kontratave dhe pagesave për investime kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha zotimet e kontraktuara janë duke u realizuar në përpikëri dhe konform kushteve të parashtruara, duke eliminuar pengesën para hyrjes në marrëveshje kontraktuese. Nëse përjashtimisht paraqitet nevoja për ndërprerje të kontratës duhet të ndiqen procedurat e nevojshme sikurse është paraparë me Ligjet dhe Udhëzimet në fuqi. Gjithashtu duhet të siguroj se hartimi i projekteve ekzekutive i paraprinë inicimit të aktiviteteve të prokurimit të kontratat për punë sipas kërkesave të UA nr. 1/2014.
8	Dobësi në planifikim të investimeve kapitale	Kryetari duhet të siguroj që bëhet një planifikim i hollësishëm dhe njësitë kërkuese duhet të vlerësojnë në mënyrë të drejtë kërkesat për prokurim.

9	Shmangie e procedurave të hapura të prokurimit	Kryetari duhet të siguroj që bëhet një planifikim i hollësishëm dhe njësitë kërkuese duhet të vlerësojnë në mënyrë të drejtë kërkesat për prokurim
10	Mangësi në inventarizimin e pasurisë	Kryetari të siguroj që komisioni i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurisë jo financiare të bëj regjistrimet dhe vlerësimin e të gjitha pasurive në posedim të komunës, dhe pas përfundimit të procesit të përgatit një raport përfundimtar mbi gjendjen e pasurive, të cilin duhet ta harmonizoj me regjistrat kontabël të komunës. Diferencat e shfaqura duhet të sqarohen dhe regjistrat duhet të azhurnohen sipas të dhënave të regjistrimeve të fundit.
11	Regjistri i pasurisë nën 1,000€	Kryetari duhet të sigurohet se regjistri i pasurise nën 1,000€ mirëmbahet, kontrollohet dhe të gjitha asetet e komunes mund të evidentohen sipas kriterëve të përcaktuara në rregullore.
12	Mospërputhje në vlerën e tokës në mes të raporteve	Kryetari duhet të sigurohet që të gjitha pasuritë e komunës të jenë të përfshira në pasqyrat financiare të komunës në mënyrë që pasqyrat financiare të tregojnë një gjendje të sakt të pasurive të saj.
13	Vonesa në depozitimin e parasë së gatshme	Kryetari duhet të sigurojë se depozitat e përditshme të parasë dhe kontrollet janë kryer ashtu siç kërkohet nga legjislacioni në fuqi.
14	Rritja e llogarive të arkëtueshme	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e mekanizmave për inkasimin e të hyrave të saj, përfshirë edhe të arkëtueshmet e mbetura nga vitet paraprake. Fillimisht duhen të shfrytëzohen të gjitha veprimet e nevojshme në kuadër të komunës, me pas të shfrytëzoj edhe masat tjera ligjore për të siguruar inkasimin e tyre.
15	Vonesa në pagesën e faturave	Kryetari duhet të përcaktoj të gjitha masat e nevojshme për adresimin e qështjeve të identifikuara dhe pagesat të bëhen në kuadër të limiteve kohore të përcaktuara me rregullat financiare.
16	Mos adresimi i rekomandimeve të NjAB	Kryetari duhet të sigurojë se do të plotësohet me personel të mjaftueshëm NjAB, si dhe të rishikojë arsyet për veprimet e limituara të ndërmarra në lidhje me rekomandimet. Gjithashtu duhet të ndermirren veprime shtesë për funksionalizimin e KA-të në mënyrë që të sigurojë mbikëqyrjen, ngritjen dhe fuqizimin e rolit të auditimit të brendshëm.
17	Dobësi në kontrollet menaxheriale	Kryetari duhet të siguroj se është hartuar politika kundër korrupsionit dhe ajo duhet të zbatohet në përpikmëri në mënyrë që të minimizohen rreziqet nga korrupsioni

18	Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm	Kryetari duhet të sigurojë që zbatimi i planit të veprimit, monitorohet në vazhdimësi dhe raportohet në baza të rregullta mujore ose tre mujore në lidhje me progresin e arritur në këtë drejtim. Rekomandimet të cilat nuk zbatohen sipas afateve, të rishikohen në një afat të shkurtër nga kryetari, si dhe të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.
----	---	---

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letër konfirmimi



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit për vitin 2018 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: "Univerzum Audit" Sh.p.k.

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Dragashit, për vitin 2018 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet e Draft Raportit Final të datës 03.06.2019 dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.



Z. Shaban Shabani

Kryetari i Komunës së Dragashit

Data: 05 Qershor 2019, Dragash